




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
FAKULTETI I EKONOMISË
DEPARTAMENTI FINANCË-KONTABILITET


UDHËZUËS PËR PËRGATITJEN DHE
MBROJTJEN E TEMËS SË DIPLOMËS

PROGRAMI I STUDIMIT
BACHELOR FINANCË-KONTABILITET



PËRMBAJTJA

HYRJE.....	3
ASPEKTE TË PËRGJITHSHME.....	3
MBI PËRGATITJEN E TEMËS SË DIPLOMËS.....	4
Tema e diplomës.....	4
MBI STRUKTURËN E TEMËS SË DIPLOMËS.....	5
Deklarata e Autorësisë.....	5
Abstrakti.....	6
Tabela e përmbajtjes.....	6
Struktura e studimit.....	6
Shtojcat.....	8
KËRKESAT TEKNIKE DHE FORMATI.....	9
SHTOJCAT.....	11
Shtojca A.....	11
Shtojca B.....	12



HYRJE

Ky material është përgatitur për studentët e programit të studimit Bachelor Financë-Kontabilitet, viti i tretë në formën e një udhëzuesi për t'i orientuar ata gjatë procesit të përgatitjes së temës së diplomës. Për të fituar Diplomën “Bachelor” në degën Financë – Kontabilitet, Fakulteti i Ekonomisë, studenti duhet të mbrojë edhe punimin e temës së diplomës.

Tema e diplomës është disiplinë e kategorisë E, e cila zhvillohet në përfundim të semestrit të gjashtë, dhe vlerësohet me 6 kredite.

Për të fituar **të drejtën e mbrojtjes së temës së diplomës**, studentit i duhet:

1. të ketë shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit, me vlerësim pozitiv;
2. të ketë miratimin dhe vlerësimin e udhëheqësit shkencor të temës së diplomës, si garantues i cilësisë akademike të punimit të tij.


ASPEKTE TË PËRGJITHËSHME

Punimi i temës së diplomës është punë individuale (në grup) që kryhet nën drejtimin e një pedagogu si udhëheqës shkencor i temës.

Përgjegjësi i Departamentit Financë - Kontabilitet, brenda semestrit të parë, viti i tretë, përcakton shpërndarjen e studentëve sipas pedagogëve.

Përzgjedhja e temës specifike kryhet nga studenti në bashkëpunim me udhëheqësin e përcaktuar (pasi të dy palët kanë filluar procedurën e përgatitjes së temës).

Departamenti përcakton listën e temave për diploma brenda muajit dhjetor, mbështetur në fushat e studimit që mbulon departamenti. Udhëheqësi i temës vlerëson studentin sipas formularit në Shtojcën B (bashkëlidhur këtij udhëzuesi).



MBI PËRGATITJEN E TEMËS SË DIPLOMËS

Gjatë përgatitjes së temës së diplomës studenti dhe pedagogu udhëheqës komunikojnë në mënyrë të vazhdueshme me njëri-tjetrin. Pedagogu përgatit dhe i bën me dije studentit/studentëve që udhëheq një plan kalendar me fazat e përgatitjes së temës së diplomës.

Studentët janë të detyruar që të respektojnë afatet e vendosura në këtë plan kalendar pasi kjo i ndihmon të organizojnë më mirë punën përgatitore të temës së diplomës. Gjithashtu kjo orienton më mirë pedagogët në udhëheqjen e studentëve dhe në dhënien e vlerësimit final për temën e diplomës së punuar nga studenti.


Tema e diplomës duhet të jetë një punim individual (në grup), i cili synon të nxisë studentët të aplikojnë një apo disa koncepte teorike të përfituara në një apo disa disiplina të studiuara nga ata. Preferohet që tema e diplomës të fokusohet në një problematikë/ aspekt të realitetit të vendit tonë.

Me punimin e temës së diplomës studenti **dëshmon se është i aftë:**

- ✚ të përmbledhë njohuritë teorike të përfituara në disiplina të ndryshme gjatë viteve të studimit;
- ✚ të dëshmojë aftësi për të kërkuar informacione në burime të ndryshme, për t'i përpunuar dhe analizuar ato;
- ✚ të aplikojë koncepte të mësuara teorikisht në një realitet të mirëfilltë ekonomik;
- ✚ të ndërthurë idetë e tij personale me parimet bazë teorike ekonomike dhe të konkludojë në lidhje me një dukuri apo fenomen aktual të ekonomisë së vendit tonë.

Tema e diplomës:

- ✚ duhet të punohet duke respektuar standardet e kërkimit dhe shkrimit akademik;
- ✚ duhet të përmbajë konkluzione logjike të nxjerra nga puna kërkimore - analitike e studentit dhe të komunikuar në mënyrë rigorozë dhe të strukturuar tek lexuesi i temës;



- ✚ duhet të paraqesë në mënyrë të qartë lidhjen mes analizës së kryer përgjatë temës së diplomës dhe përfundimeve dhe rekomandimeve të dhëna në fund të saj (pa dalë në përgjithësime që nuk bazohen në punën konkrete të bërë nga studenti).


MBI STRUKTURËN E TEMËS SË DIPLOMËS

Tema e diplomës duhet të jetë një punim i cili respekton strukturën standarde si më poshtë:

- Deklarata e Autorësisë
- Faqet Paraprake
 - Kapaku (Aneksi I)
 - Abstrakti
 - Mirënjohja (nuk është e detyrueshme)
 - Tabela e përmbajtjes
- Studimi i temës i ndarë në kapituj
 - Hyrja
 - Lista e tabelave, diagrameve, shtojcave
 - Lista e shkurtimeve
- Shqyrtimi i literaturës së fushës
- Metodologjia
- Diskutimi
- Përfundime dhe konkluzione
- Lista e referencave/Bibliografia
- Shtojcat (nëse ka)

Deklarata e Autorësisë

E drejta e autorit për punim është subjekt i mbrojtjes të së drejtës së autorit sipas legjislacionit në fuqi. Cdo akt plagjiarizmi i provuar nga pedagogu drejtues i temës apo komisioni i mbrojtjes do të ndiqet sipas masave të parashikuara në rregulloren e Universitetit.



Abstrakti

Abstrakti është një përmbledhje që përfshin tre deri në katër paragrafë mbi temën, problematikën, pyetjen kërkimore, argumentin kryesor si dhe bazën teorike e metodologjike të punimit. Abstrakti duhet të jetë jo më shumë se 350 fjalë.

Në fund të abstraktit vendosen fjalët kyce të përdorura në punim. Abstrakti shkruhet me hapësirë 1 mes rreshtave.

Tabela e përmbajtjes


Ky element **NUK** është opsional. Tabela është e domosdoshme si për vlerësuesit e temës së diplomës ashtu dhe për cdo lexues të mëvonshëm të punimit. Ajo duhet të përfshijë në mënyrë të detajuar titujt e kapitujve, nëntitujt dhe titujt e seksioneve të çdo kapitulli si dhe numrat e faqeve përkatëse.

Titujt, nëntitujt dhe titujt e seksioneve duhet të diferencohen nga njëri-tjetri me anë të renditjes (shiko seksionin: Kërkesa teknike dhe formati).

Struktura e studimit

Punimi i diplomës duhet të respektojë **strukturën e detyrueshme** si më poshtë:

Struktura	Përmbajtja	Përqindja totale (e përafërt)
Hyrje	Ajo prezanton fushën e studimit dhe çështjen e marrë në studim	10%
Kapitulli I	Skeleti teorik. Shqyrtimi i literaturës së fushës së çështjes	20%
Kapitulli II	Metodologjia (kur është e aplikueshme). Metodatat dhe instrumentat e përdorura në studim	15%
Kapitulli III:	Rezultat e studimit	20%
Kapitulli IV	Diskutimi. Studenti analizon qëllimin e temës dhe pyetjet që ngrenë në lidhje me të. Rezultatet e temës krahasohen me pyetjet e	20%



	ngritura në punim si dhe analizohen pyetjet e reja që mund të dalin gjatë procesit të shkrimit. Në diskutim studenti paraqet komentet dhe këndvështrimin e tij në lidhje me temën.	
Konkluzionet	Përfshijnë gjetjet kryesore të studimit	10%
<i>Bibliografia</i> <i>/Lista e</i> <i>Referencave</i>		5%

Studentët nxiten të përdorin referenca të botimeve të ndryshme të fushës dhe sidomos ato të një natyre shkencore të njohura dhe të besueshme nga ekspertë të fushës. Materialet e marra nga media apo interneti duhet të jenë të mbështetura në evidenca. Një punim diplome pa listë referencash do të konsiderohet i papranueshëm për vlerësim.

Lista e referencave duhet të ndahet në komponentët e mëposhtëm:

(i) Referencat brenda tekstit

Citimet e drejtëpërdrejta, të marra nga një autor vendosen në thonjëza.


Citimi i burimeve brenda tekstit të diplomës bazohet në stilin APA: Autori i cituar vendoset në kllapa dhe shoqërohet me vitin e botimit të punës së cituar dhe me numrin/at e faqes/ve, për shembull (Duraj, 2006, faqe 11).

(ii) Shënimet në fund të faqes

Këtu përfshihet i gjithë materiali shtesë, i cili nuk është integruar në tekstin e temës, kryesisht për arsye të limiteve të numrit të fjalëve si dhe referencat e burimeve.

(iii) Bibliografia

Bibliografia vendoset në fund të punimit.



Në listën e bibliografisë jepen hollësisht të dhënat e secilit botim, mbiemri dhe emri i autorit (nëse ka grup autorësh vihet në rend të zhdrejtë vetëm autori i parë; titulli i botimit; emri i shtëpisë botuese; qyteti dhe shteti; viti i botimit).

Në rastin e citimeve nga revistat shkencore ndiqet formati i mëposhtëm: Duraj, B. Shkurti, R. (2010) "Analiza multifaktoriale e parashikimit të falimentimit të ndërmarrjeve shtetërore", Journal of Academic research, Vol. 2, f. 36-55.

Burime Parësore - janë burimet e drejtpërdrejta të marra direkt nga autori i tyre.

Burimet dytësore - janë burimet të cilat citojnë një/disa autorë të tjerë. Studenti inkurajohet të përdorë burimet parësore për të shmangur keqinterpretimet apo deformimet e burimeve, ndaj për këtë arsye burimet dytësore duhet të përdoren me një lloj rezerve.


Burime nga Interneti (libra elektronike, revista elektronike dhe faqe interneti) përfshijnë mbiemrin e autorit, inicialin e emrit, vitin, llojin e burimit, datën e marrjes së materialit dhe adresën URL. Rekomandohet që materialet e marra nga interneti të printohen ose të ruhen më vete në një dosje (folder) personale.

Shtojcat

Këtu mund të përfshihen ilustrime e shembuj shtesë, statistika të përdorura të cilat janë shumë të gjata që të përfshihen në tekst dhe që të mos e shkëpusin lexuesin nga diskutimi origjinal. Për tema diploma të bazuara mbi pyetësorë, është i nevojshëm një informacion i hollësishëm mbi të intervistuarit, koha dhe lokaliteti i vëshgimeve, si dhe struktura e pyetjeve ose pyetësi i përdorur gjatë punës në terren. Ky informacion shton besueshmërinë e informacionit të dhënë në temë.

Për të llogaritur kufirin e fjalëve dhe të faqeve rekomandohet metoda e mëposhtme e llogaritjes:

- Maksimumi 2.310 karaktere/faqe për punimin e tezës
- Një radhë do të ketë 70 karaktere me një maksimum 33 rradhë për faqe.



KËRKESAT TEKNIKE DHE FORMATI

Punimi duhet të respektojë kërkesat e formatit. Nëse punimi nuk prezantohet sipas formatit të kërkuar, ai nuk pranohet deri sa të plotësohen të gjitha kërkesat e formatit.

Punimi duhet përgatitet në gjuhën shqipe letrare dhe pa gabime ortografike. Lejohet përdorimi i termave të njohur të pranuar nga gjuha angleze.

Punimi duhet të jetë i ndarë në kapituj logjikë dhe teksti të jetë i ndarë në paragrafë.

Shmangni fjalitë e gjata.

I kushtoni rëndësi fjalorit të përdorur, rregullave të drejtëshkrimit dhe pikësimit.

Tema e diplomës duhet të dorëzohet në një kopje të printuar dhe një kopje elektronike (CD) pranë sekretarisë së Departamentit. Studenti duhet të dorëzojë së bashku me temën e diplomës dhe vlerësimin e plotësuar nga pedagogu udhëheqës (sipas formularit të paraqitur në Shtojcën B bashkëlidhur).

Tema e diplomës duhet të jetë minimumi 30 faqe (këtu nuk përfshihen faqet e abstraktit, referencave dhe shtojcat).

Shkrimi i përdorur në punim duhet të jetë Times New Roman, madhësia e shkronjës 12, hapësira mes rreshtave 1.5.

Shënimet në fund ta faqes duhet të shkruhen me shkronja me madhësi 10-she dhe me hapësirë mes rreshtave 1.

Titujt e kapitujve shkruhen me madhësi shkronje 14 me Bold, kurse nëntitujt me 12 me Bold.

Marxhinat e faqes për të gjithë tekstin janë:


- Marxhina e sipërme: 2.5 cm
- Marxhina e poshtme: 3 cm
- Marxhina e majtë: 2.5 cm
- Marxhina e djathtë: 2.5 cm

Numrat e faqes vendosen poshtë në mes të faqes. Hyrja duhet të ketë numra romakë.

Pjesa e punimit duhet të ketë numra arabë.


Udhëzues për përgatitjen dhe mbrojtjen e temës së diplomës

Bachelor Financë-Kontabilitet



Tabelat dhe grafikët duhet të jenë të emërtuara në mënyrë progresive dhe duhet patjetër të citohet burimi i informacionit të përfshirë në punim nëse nuk është punë e studentit. Numri i tabelës duhet të ndjekë numrin e kapitullit të cilit i përket.

Udhëzues për përgatitjen dhe mbrojtjen e temës së diplomës
Bachelor Financë-Kontabilitet



Shtojca A

**UNIVERSITETI FAN S. NOLI
FAKULTETI I EKONOMISË
DEPARTAMENTI I FINANCË-KONTABILITETIT
PROGRAMI BACHELOR**

Temë Diplome

EUROIZIMI I NJËANSHËM I SHQIPËRISË


Diplomë BACHELOR

Emri/Mbiemri i Studentit

Grupi _____

Udhëheqës: _____

Korçë, [VITI]



Shtojca B

FORMULARI I VLERËSIMIT TË DIPLOMËS NGA UDHËHEQËSI

Emri i studentit diplomant: _____

Fakulteti i Ekonomisë **Dega Financë-Kontabilitet** **Grupi I** _____

Titulli i temës së punimit:

Nr.	Kriteret e vlerësimit	Pikët e parashikuara	Pikët e fituara
1.	Përkushtimi i studentit dhe respektimi i rregullave dhe detyrimeve të procesit të diplomimit	15	
2.	Rrjedha logjike e materialit, qartësia dhe stili i shkrimit	20	
3.	Analiza, interpretimi i gjetjeve dhe hartimi i përfundimeve në përputhje me objektivat e vendosura të punimit	25	
4.	Vlera dhe dobia e punimit (adresimi i një problemi konkret dhe aktual)	20	
5.	Cilësia e të shkruarit (respektimi i kërkesave të formatimit, i rregullave të drejtëshkrimit dhe pikësimit sipas manualit)	10	
6.	Referencat e përdorura (cilësia dhe mjaftueshmëria e tyre)	10	
TOTALI		100	

